

**Njoftim për përqendrim me të cilin TSS EVROPA B.V, Holandë dhe ADAM GORAL
FONDACIJA RODZINA, Poloni do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ASSECO
POLAND SA, Poloni**

(lënda nr. 08-97/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më 05.06.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ana e TSS EVROPA B.V, me seli të regjistruar në Atoomweg 50, 3542AB Utreht, Holandë, dhe ADAM GORAL FONDACIJA RODZINA, me seli të regjistruar në rr. Dabrovskiego 4, lok. 6, 35-033 Zheshov, Poloni, mbi ASSECO POLAND SA, me seli të regjistruar në rr. Olhova 14, 35-322 Zheshov, Poloni. TSS EUROPA B.V, në këtë përqendrim, vepron përmes shoqërisë të varur saj në pronësi të plotë – JUKON NIEBESKI CAPITAL B.V., me seli të regjistruar në Atoomweg 50, 3542AB Utreht, Holandë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

TSS EVROPA B.V përmes shoqërive të saj të varura ofron një gamë të gjerë të zgjidhjeve softuerike afariste dhe është aktive, ndër të tjera, në sektorin financiar, shitjen me pakicë, sektorin juridik, qeverisjen, pasuritë e paluajtshme, kujdesin shëndetësor dhe sektorin automobilistik. TSS EVROPA B.V kontrollohet përfundimisht nga Constellation Software Inc. ("CSI"). CSI blen, menaxhon dhe zhvillon biznese që ofrojnë zgjidhje softuerike në të gjithë botën ("Grupi CSI").

CSI është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së saj të varur, IN2 SHPKNJP Shkup, me seli në bulevardin Kuzman Josifovski - Pitu 15 - ndërtesa Neokom/kati 5, Aerodrom, Shkup – Aerodrom, me aktivitet të regjistruar – konsulencë kompjuterike. IN2 SHPKNJP Shkup kryesisht merret me inxhinieri të informacionit dhe shërbime IT, duke u fokusuar në zhvillimin, zbatimin, mbështetjen dhe mirëmbajtjen e produkteve të , IN2 SHPKNJP dhe zgjidhjeve partnere. Në bashkëpunim me anëtarët tjerë të grupit, kompania vendos sisteme të reja informacioni dhe ofron konsulencë IT në sektorë të ndryshëm.

ADAM GORAL FONDACIJA RODZINA është një fondacion familjar i regjistruar sipas ligjeve të Polonisë.

ADAM GORAL FONDACIJA RODZINA nuk ka prezencë operative në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ushtron ndonjë aktivitet komercial afarist në Maqedoninë e Veriut.

ASSECO POLAND SA është një kompani holding e grupit të kompanive Asseco ("Grupi Asseco"), të cilat janë aktive në sektorët e softuerit dhe teknologjisë së informacionit (IT).

Asseco është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes tri shoqërive të varura:

- ASEE BSS SHPKNJP, Shkup, me seli të regjistruar në rr. "Naroden Front" 17, 1000 Shkup, me aktivitet të regjistruar – tregti me shumicë me kompjuterë, pajisje periferike kompjuterike dhe softuer;

- ASEE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. "Naroden Front" 17, 1000 Shkup, me aktivitet të regjistruar – programim kompjuterik; dhe
- Pajten SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. "Naroden Front" 17, 1000 Shkup, me aktivitet të regjistruar – tregti me shumicë me kompjuterë, pajisje periferike kompjuterike dhe softuer.

Shoqëritë e varura maqedonase të Asseco ofrojnë kryesisht një gamë të gjerë të produkteve softuerike të destinuara për sektorin bankar dhe financiar.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit, si treg relevant mund të definohet tregu i programimit kompjuterik në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin preliminar, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i propozuar mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim te Komisioni. Komentet dhe mendimet e palëve të treta mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me email në: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.06.2025

Shkup